



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 35/5 Prot.

Tiranë, më 19.12 2023

VENDIM

Nr. 139 dt. 19.12 2023

“PËR

MIRATIMIN E PËRCJELLJES SË DOKUMENTACIONIT TË DR. ELTON SPAHIU
PËR FITIMIN E TITULLIT “PROFESOR I ASOCIUAR” PRANË KPPA”

Në zbatim të nenit 38, 60 pika 3, 79 pika 7 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, kreut IV pika 1 dhe 2 të V.K.M-së nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, nenit 20, 27 të Statutit të UST-së, nenit 7 të Rregullores së UST-së, nenit 4, 7 dhe 13 të Rregullores së Veprimtarisë së Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së, mbështetur në shkresën e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit nr.3393 prot., datë 07.12.2023 “Përcjellje e dokumentacionit për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar të Dr. Elton Spahiu”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 19.12.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë përcjelljen e dokumentacionit të Dr. Elton Spahiu për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar”, pranë Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së.
2. Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik të vijojë me procedurat sipas kuadrit ligjor në fuqi.
3. Një kopje e këtij vendimi ti përcillet Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, Njësisë Kryesore Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Agron KASA

